



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 12

Prishtinë, më 23.6.2011, ora 11,00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

**PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Afërdita Berisha-Shaqiri, Sevdije Lama, Nijazi Idrizi, Daut Haradinaj, Etem Arifi dhe Salih Morina.

Mungoi : Liburn Aliu,

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: zyrtarë, bashkëpunëtor, përfaqësues dhe vëzhgues të interesuar, përfaqësues, media dhe Arsim Avdijaj.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës ;**
2. **Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 15.6.2011 dhe 6.6.2011;**
3. **Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme ;**
4. **Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës duke sqaruar kërkesën shtesë në pikën 4 për të shqyrtuar një shkresë nga Oda e Veterinarëve të Kosovës për çka është ftuar kryeshefi i Agjencisë dhe përzgjedhjen e ekspertit rreth projektligjit për verëra, gjithashtu në pikën e 4.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime me këto sqarime shtesë nga kryetari.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 6.6.2011 nr. 10 dhe 15.6.2011 nr.11

Kryetari konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 6.6.2011 dhe 15.6.2011 pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme

Kryetari Nait Hasani njoftoi se shqyrtimi i projektligjit për regjistrin e pronave ka përfunduar në grupin punues, ndaj ftoi kryesuesin **Salih Morina** të jap sqarimet për amendamentet e hartuara. Z. Morina elaboroi për punën e frytshme në grupin punues ku janë mbajtur takimet e parapara me përfaqësuesit e ministrisë dhe ekspertin e angazhuar z. Skender Sina. Rekomandimi i grupit punues, vazhdoi, bazohet kryesisht në mendimin e ekspertit i cili ka sugjeruar të fshihet një nënparagraf sa i përket vendimeve të Agjencisë Kosovare për Prona ngase këto vendime në të kaluarën kanë hapur rrugë elementeve diskriminuese, ndërkaq janë përkrahur edhe ca përmirësime teknike juridike nga konsulenti ligjor i NDI z. **Arsim Avdijaj**.

Nijazi Idrizi kërkoi sqarime rreth pikës 7.2 tek Amendamenti 3, çka nënkuptohet me Vendimin e organit administrativ shtetëror. **Arsim Avdijaj** tha se fjala është për vendimet e organeve shtetërore të dy niveleve (qendrore dhe lokale) administrative, ndaj edhe poçes hiqet 7.2-shi, pika e radhës 7.7-shi mbulon atë mungesë, për çka edhe **Salih Morina** tha se Hajzer Bubaku nga Agjencia ka sugjeruar të mbetet ashtu, ngase është term i përgjithësuar dhe nuk mund të thjeshtësohet më tepër, megjithatë, shtoi z. Avdijaj, mund të kërkohet nga eksperti mendimi detalizues deri në përfundim të leximit të dytë. **Nait Hasani** sqaroi se raporti prapë kthehet në këtë komision pas shqyrtimit nga komisionet e kuvendit, ndaj nëse ka ndonjë parregullsi, mund të eliminohet në vazhdim deri në leximin e dytë. **Daut Haradinaj** u pajtua me mendimet e dhëna, ngase edhe komuna menaxhon dhe përforcon këtë nen duke nxjerr aktet (vendimet) ekzekutive.

Kryetari konstatoi se Komisioni me 7 vota “për” dhe një “abstenim” (Nijazi Idrizi) nxori këtë :

P Ë R F U N D I M

Miratohet Raporti me Amendamente i raportuesit-Kryesuesit të grupit punues Salih Morina.

I rekomandohet Kuvendit të Kosovës miratimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme me amendamentet e propozuara nga Komisioni për Bujqësi dhe Mjedis, si vijon :

Amendamenti 1

Neni 1 i projektligjit, fshihet fjalia: “në tekstin e mëtejme: Ligji) i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 34 (1 gusht 2008)”.

Amendamenti 2

Neni 2, i Projektligjit të riformulohet:

Neni 1, paragrafi 3 i ligjit riformulohet si në vijim:

1.3. AKK-ja me akt nënligjor përcakton nivelin e pagesave për shërbimet e ofruara në regjistrimin e të drejtave në pronën e paluajtshme në përputhje me koston e kryerjes së shërbimeve.

Amendamenti 3

Neni 5 i projektligjit të riformulohet:

Neni 3, paragrafi 7 i ligjit riformulohet si në vijim:

7. Të drejtat mbi pronën e paluajtshme që parashihen sipas nenit 2 të ligjit regjistrohen në bazë të:

7.1. Vendimit të plotëfuqishëm të gjykatës,

7.2. Vendimit të organit administrativ shtetëror,

7.3. Kontratës për bartjen e së drejtës së pronës së paluajtshme të vertetuar nga organi kompetentë;

7.4. Vendimit apo kontratës për privatizim të lëshuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit,

- 7.5. Vendimit të Komisionit për Rindërtimin e Kadastrit,
- 7.6. Vendimit të Komisionit për Rregullimin e tokave, dhe
- 7.7. Dokumentit tjetër që me ligje të veçanta parashihet regjistrimi i të drejtave pronësore.

4. Të ndryshme

Nait Hasani ftoi komisionin që në këtë pikë të deklarohet rreth tri propozimeve për ekspert të projektligjit për verëra siç janë Fejzullah Berisha, Rrahman Kabashi dhe Selami Vuçitërna, CV-të e të cilëve anëtarët e komisionit kanë pasur mundësi të shikojnë deri më sot. Meqenëse anëtarët prezent të komisionit nuk kishin propozime konkrete, kryetari i Komisionit sugjeroi z. **Fejzullah Berisha** si një emër i njohur në fushën e enologjisë, i cili sipas bisedimeve të deritanishme me NDI do të bashkëfinancohet bashkërisht me fondin e komisionit dhe NDI-së. Komisioni me konsensus nxori këtë:

V E N D I M

- I. **Fejzullah Berisha** nga Rahoveci, angazhohet për kohë të shkurtër si ekspert i jashtëm rreth projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.02/L-8 për Verërat.
- II. Ngarkohet grupi punues, koordinatori i komisionit dhe përfaqësuesi i NDI Shefki Kastrati që brenda dy ditë pune të përgatisin termat e referencës, ku definohen përgjegjësitë e ekspertit, kushtet e kompensimit dhe afatet kohore për dorëzimin e ekspertizës në Komision.

Në vazhdim **Nait Hasani** ftoi kryeshefin e AVUK-ut z. **Valdet Gjinovci** lidhur me një shkresë nga Oda e Veterinarëve të Kosovës lidhur me vaksinimin e qenve kundër tërbimit dhe trajtimi i tyre kundër parazitit të Ehinokokut, përkatësisht pse në disa komuna nuk janë vaksinuar qenët dhe nuk janë siguruar tabletat kundër sëmundjes së Ehinokokut.

z. **Gjinovci** tha se duke u bazuar në Ligjin e Veterinës 21/2004 është hartuar UA 10/2005 ku është rregulluar obligimi i autoritetit kompetent për vaksinimin e qenve, sigurimi i vaksinave etj. Prej vitit 2002 deri 2005 ky obligim i ka takuar AVUK-ut, mirëpo me UA në nenin 4 obligohet vaksinimi në terren përkatësisht të Kuvendeve Komunale, ndërkaq sigurimin e vaksinave falas e bënë agjencia, gjithashtu është rregulluar çështja e eliminimit të qenve endacak. Ai në vazhdim më hollësisht sqaroi cilat komuna sa paguajnë për këtë shërbim. **Afërdita Berisha** pyeti a përfshihen edhe qenët endacak me vaksinim, përgjigja ishte pozitive për të cilët është edhe çerdhja e veçantë ngase paraqesin rrezik potencial.

Nait Hasani, Nijazi Idrizi parashtruan pyetje konkrete në rast të moskryerjes së obligimeve nga komunat, çka mund të ndërmarr Agjencia, ngase kemi raste alarmante si p.sh. të vdekjes së fëmiut në Kamenicë. Përgjigja ishte se sanksione nuk mund të ketë ngase problemi është tek mungesa e buxhetit. Mirëpo në vazhdim prapë pasuan pyetjet nga anëtarët e komisionit pse nuk veprohet asgjë në këto raste. Kryeshefi i AVUK tha se gjatë vitit të kaluar ka filluar vaksinimi nga ajri, mirëpo **Salih Morina** pyeti për rastin e Malishevës, a obligohet komuna me krye patjetër këtë shërbim, dhe nëse jo a e merr këtë obligim agjencia (edhe **Sevdije Lama** u interesua ngjashëm). **Nait Hasani** e përmbylli këtë çështje me pyetjen : çka vepron AVUK nëse nuk zbatohet ligji.

Kryeshefi kërkoi nga komisioni mundësinë e dërgesës në këto pyetje përgjigjet me shkrim veç e veç, për çka u pajtua edhe komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 12,10.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani